



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

V E N D I M

Nr. 03, datë 29.10.2015

PËR

MIRATIMIN E LEJES SË NDËRTIMIT PËR OBJEKTIN: "IMPIANTI I DEPOZITIMIT, SHPËRNDARJES DHE TREGËTIMIT TË NËNPRODUKTEVE TË NAFTËS, NË ZONËN ENERGETIKE DHE INDUSTRIALE TË PORTO-ROMANOS, BASHKIA DURRËS

Në mbështetje të neneve 27 dhe 28 të Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 "Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit", i ndryshuar, Vendimit Nr. 408, datë 13.05.2015 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit", e ndryshuar dhe Vendimit Nr. 877, datë 03.10.2013 të Këshillit të Ministrave "Për përbërjen e Këshillit Kombëtar të Territorit", me propozimin e Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë, Këshilli Kombëtar i Territorit,

VENDOSI:

1. Miratimin me kusht të Lejes së Ndërtimit për objektin: "Impianti i depozitimit, shpërndarjes dhe tregëtimit të nënprodukteve të naftës, në zonën energjetike dhe industriale të Porto-Romanos, Bashkia Durrës", me subjekt kërkues shoqërinë "NASAEL" sh.a.
2. Dokumenti i Lejes së Ndërtimit i jepet subjektit kërkues vetëm pas:
 - a) pajisjen me Leje Mjedisore nga Ministria e Mjedisit;
 - b) nënshkrimit të kontratës me Agjencinë e Shërbimit Arkeologjik (ASHA) për mbikëqyrjen arkeologjike gjatë ndërtimit;
 - c) pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukturë, për llogari të Njësisë së Qeverisjes Vendore.
3. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit në bashkëpunim me Ministrinë e Energjisë dhe Industrisë për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

EDI RAMA



ZËVENDËS KRYETARE E KKT

EGLANTINA GJERMENI

MINISTËR I ZHVILLIMIT URBAN

DAMIAN GJIKNURI

MINISTËR I ENERGISË DHE INDUSTRIË



SEKRETARE E KKT

LEDIA TOTA

DREJTORE E AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT